



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

3114/4  
Nr. Prot.

Tiranë, më 03-11/2022

URDHËR

Nr. 592, datë 03 / 11 / 2022

**“PËR DHËNIEN E MASËS DISIPLINORE PARALAJMËRIM ME SHKRIM PËR  
NOTERIN [REDAKTUAR]”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 25, të gërmës “b”, “c”, të pikës 2, pikës 4, si dhe pikës 5, të nenit 26, të Ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

**KONSTATOJ:**

Me Urdhrin nr. 244, datë 31.05.2021 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë noterit [REDAKTUAR], bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.51, datë 03.02.2022, “Për miratimin e programit vjetor të inspektimit të noterëve për vitin 2022”.

Objekti i këtij inspektimi administrativ ka qenë verifikimi i zbatimit të ligjit nr.110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, ligjit nr. 7829/1994 “Për noterinë” i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së noterëve, për periudhën 2018-2022 nga ana e noterit [REDAKTUAR]

1. Në përfundim të kryerjes së inspektimit pranë zyrës së noterit [REDAKTUAR] dhe analizës ligjore të akteve dhe veprimeve noteriale, objekt i kontrollit administrativ, grupi i kontrollit hartoi raportin “Për kryerjen e kontrollit në zyrën noteriale të noterit publik Brunilda Demiri” në të cilin, janë relatuar gjetjet përkatëse për të cilat vlerësojmë se, lidhur me mënyrën e hartimit të akteve/veprimeve noteriale dhe detyrimit të noterit për përpilimin e tyre sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, konstatohen pjesërisht shkelje të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë” i ndryshuar, sa i përket dokumentacionit që duhet bashkëlidhur këtyre akteve.
2. Lidhur me verifikimin e kontratës së sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, rezulton se noteri Brunilda Demiri ka respektuar pjesërisht detyrimin e parashikuar në nenin 65, të ligjit nr.110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, dhe nenin 25 të ligjit nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, pasi noteri nuk ka lidhur kontratë të sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë noteriale, për vitet 2018 (6 mujori i II-të I këtij viti) viti 2019, viti 2020 si dhe 6 mujorin e I-rë të vitit 2021.

## PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6 dhe 7, të Ligjit Nr.8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të nenit 25, të gërmasë "b", dhe "c", të pikës 3, pikën 5 të nenit 26, të Ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë", i ndryshuar;

## URDHËROJ:

1. Dhënie e masës disiplinore "Paralajmërim me shkrim" noterit [REDAKTUAR], anëtar i Degës Vendore të Noterisë Korçë.
2. Detyrimin e noterit [REDAKTUAR] për respektimin dhe zbatimin e parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, lidhur me kontratën e sigurimit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë noteriale.
3. Respektimin nga noteri të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në fuqi, lidhur me të gjithë elementët dhe dokumentet shoqërues që duhet të ketë një akt/veprim noterial.
4. Ky Urdhër t'i njoftohet menjëherë noterit [REDAKTUAR] si dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
5. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
6. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë:

MINISTRI

  
Ulsi Manja

